



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +383-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 485
Dt 27.03.2020

Në bazë të përgjegjësive të dhëna nga Statuti i përkohshëm i UMIB-it,
Pas konsultimeve me prorektorët, dekanët, stafin akademik, studentët dhe administratën e UMIB-it,
Pas konsultimit me MASHTI-n dhe në marrëveshje me Konferencën e Rektorëve të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës.
Për shkak të përhapjes së pandemisë Covid 19, dhe
Vendimit të qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërprerjen e procesit mësimor në territorin e Kosovës,

Rektori i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" merr:

VENDIM

- I. Procesi mësimor në UMIB, në të gjitha njësitë akademike dhe në të gjitha nivelet, është duke u zhvilluar dhe do të vazhdojë në formatin on-line, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Mësimi on-line zhvillohet në platformat:
 - <http://smu.umib.net>
 - <https://meet.google.com/>
 - <https://classroom.google.com/>
- III. Dekanët duhet të ndërmarrin të gjitha masat që stafi akademik dhe studentët të organizojnë ligjëratat dhe ushtrimet on-line.
- IV. Stafi akademik dhe studentët duhet të organizojnë procesin mësimor rregullisht, në bazë të orarit mësimor, dhe t'i kryejnë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- V. Stafi akademik dhe studentët mund të ndjekin **Udhëzuesit për përdorimin e platformave për mësim on-line** të përgatitur nga Zyra e TI-së, të publikuar në web-faqen e UMIB-it.
- VI. Zyra e TI-së është në ndihmë të stafit akademik për organizimin e mësimit on-line.
- VII. Sekretari përgjithshëm dhe administrata do ta përshtatin punën e tyre në përkrahje të mësimit on-line.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe vlen deri në marrjen e një vendimi tjetër.



Rektor i UMIB-it

Prof. Dr. Alush Musaj